

URDHËR

Nr. 45, Datë 08/08/2014

PER DISA MASA PËR ZHVILLIMIN E KONKURSEVE TË PRANIMIT, PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR, PËR VITIN AKADEMIK 2014 – 2015, NË FAKULTETET E UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Në bazë të nenit 33 e 75 të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Nr. 20, datë 06.08.2014 të MAS "Për zhvillimin e konkurseve të pranimit dhe tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2014-2015" si dhe nenit 39 të Statutit të Universitetit të Arteve,

URDHËROJ

1. Pranimet në të gjitha programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2014-2015, të bëhen mbi bazën e rezultateve të Maturës Shtetërore dhe rezultateve të fituara në konkursin e pranimit, të organizuar nga fakultetet e UART.
2. Në Universitetin e Arteve rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën **30%** dhe rezultatet e konkursit të pranimit në masën **70%**.
3. Pikët maksimale që mund të fitojë një kandidat në konkurrim në një nga programet e studimit të UART janë të përcaktuara në Udhëzimin Nr. 20, datë 06.08.2014 të MAS.
4. Kandidati i cili nuk arrin të fitojë pikët minimale të përcaktuara në Udhëzimin Nr. 20, datë 06.08.2014 të MAS, në programin e studimit për të cilin konkurren, nuk fiton të drejtën e studimit.
5. Konkurset e pranimit në UART do të zhvillohen nga data 01 shtator 2014 deri në datën 05 shtator 2014.
6. Tarifa e regjistrimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkursin e pranimit, në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Arteve është **5.000 (pesë mijë) lekë**.

7. Tarifa e regjistrimit për konkurim në programet e studimit të ciklit të parë në UART, të arkëtohet nëpërmjet sistemit bankar ose zyrave të Postës Shqiptare, për llogari të UART.
8. Fakultetet e Universitetit të Arteve të kenë bërë publike rregulloret dhe programet e konkurseve jo më vonë se data 08 gusht 2014. Po ashtu Rregulloret e konkurseve të jenë të publikuara edhe në faqen zyrtare të UART.
9. Regjistrimi i kandidatëve për konkurset e pranimit të bëhet pranë sekretarive të Fakulteteve të UART duke filluar **nga data 21 gusht 2014**, deri **në orën 12.00 të datës 28 gusht 2014**. Sekretaritë mësimore të fakulteteve në UART, të kryejnë veprimet e regjistrimit të kandidatëve për konkurim nga **ora 08:00 deri në orën 18:00**.
10. Regjistrimi i kandidatëve bëhet duke u bazuar në listën e dërguar nga AKP për të gjithë kandidatët që kanë plotësuar formularin A2.
11. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e akorduara për Shqiparët jashtë kufijve të vendit, të verbrit, Romët dhe Ballkano-Egjiptianët, invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë, jetimët, shtetasit e huaj si dhe kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi apo transferim studimesh, që do të marrin pjesë në konkurset e pranimit për programet e studimit të ofruara nga UART, aplikojnë drejtpërdrejt pranë sekretarive të Fakulteteve në Universitetin e Arteve.
12. Regjistrimi i kandidatit bëhet nëpërmjet një mjeti identifikimi personal:
 - i. Për kandidatët shtetas të Republikës së Shqipërisë regjistrimi bëhet me paraqitjen e kandidatit i cili duhet të tregojë dokumentin e identifikimit personal (kartë identiteti ose pasaportë për jashtë shtetit) si dhe vërtetimin e pagesës së tarifës së regjistrimit në favor të UART;
 - ii. Për kandidatët nga trojet regjistrimi bëhet me paraqitjen e kandidatit i cili duhet të tregojë dokumentin e identifikimit personal (kartë identiteti ose pasaportë për jashtë shtetit), fotokopje e diplomës e shkollës së mesme e noterizuar si dhe vërtetimin e pagesës së tarifës së regjistrimit në favor të UART.
13. Në momentin e regjistrimit kandidati për konkurs pajiset nga sekretaria e fakultetit me **Fletën e Regjistrimit**. Kjo fletë përmban:
 - I. Emrin dhe mbiemrin e kandidatit.
 - II. Programin e studimit në të cilin konkuron.
 - III. Datën dhe orën e paraqitjes për konkurim.
 - IV. Datën dhe orën e regjistrimit.

- Kjo fletë të përgatitet në 2 kopje dhe të firmoset nga sekretaria e fakultetit dhe kandidati për konkurs.
14. Me përfundimin e procedurave të regjistrimit, sekretaritë mësimore të verifikojnë listat e të rregjistruarëve me listën e dërguar nga AKP, dhe **në datën 29 gusht 2014, ora 12:00**, të shpallin menjëherë listat e konkurrentëve të regjistruar dhe ti afishojnë ato në vende të dukshme, në mjediset e fakultetit përkatës.
 15. Konkurset e pranimit në UART monitorohen nga përfaqësues të autorizuar të MAS, si dhe të Rektoratit të UART.
 16. Dekanët e fakulteteve të UART janë përgjegjës për zbatimin e Rregulloreve të konkursit të pranimit në UART të miratuara në Senatin Akademik.
 17. Rezultatet e konkurseve të pranimit të hidhen në portalin e Maturës Shtetërore online nga sekretaritë e fakulteteve sipas procedurave të Udhëzimit teknik të dërguar nga AKP. Më pas listat të dërgohen brenda tre ditëve në Rektorat, në tre kopje, në formë shkresore dhe elektronike (në CD).
 18. Pasi kanë kryer veprimet e përcaktuara më sipër, fakultetet e UART të shpallin në vende të dukshme listën emrore të kandidatëve me pikët e fituara në konkursin e pranimit. Këto lista të jenë të firmosura nga Dekani i fakultetit përkatës. Po ashtu këto lista të shpallen edhe në faqen zyrtare të UART.
 19. Gjatë periudhës së zhvillimit të konkurseve të pranimit, Dega e Shërbimeve dhe Shërbimi i ruajtjes me roje civile të angazhohen maksimalisht për ruajtjen e rregullit dhe të qetësisë të mjediseve në Universitetin e Arteve. Të ushtrohen kontrole të vazhdueshme në të gjitha mjediset. Shoqëria që ofron shërbimin e ruajtjes me roje civile të njoftohet për të dyfishuar numrin e rojeve civile në mjediset e UART si dhe për të mbajtur në zonën për rreth UART një grup efektivësh të gatshëm për çdo rast emergjence.
 20. Gjatë periudhës nga data 30.08.2014 deri në datën 06.09.2014, zona e parkimit të Universitetit të Arteve duhet të qëndroje e lirë dhe të lejohet hyrja vetëm e automjeteve të përcaktuara në një listë të veçantë të nënshkruar nga Kancelarja e UART. Punonjësi i shërbimit i vendosur në postin e shërbimit në zonën e parkimit, ka përgjegjësi për kontrollin e lëvizjes së automjeteve.
 21. Hyrja e personelit akademik dhe personelit administrativ gjatë periudhës së zhvillimit të konkurseve do të lejohet vetëm nga hyrja në rrugën Lekë Dukagjini.

22. Hyrja e konkurrentëve do të lejohet vetëm nga hyrja kryesore përballë Sheshit Nënë Tereza. Hyrja e tyre do të lejohet vetëm kundrejt paraqitjes së dokumentit të identifikimit.
23. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik, Fakulteti i Arteve të Bukura, Kancelari i UART, Drejtoria Ekonomike, Dega e Shërbimeve të UART, personeli akademik dhe administrativ i UART, kandidatët pjesëmarrës në konkurset e pranimit që organizohen dhe zhvillohen në UART, personat e autorizuar për të qendruar në mjediset e UART gjatë zhvillimit të konkurseve të pranimit, si dhe personeli i shërbimit të ruajtjes me roje civile.
24. Kopje e këtij urdhri dërgohet zyrtarisht, në MAS dhe AKP.
25. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet publikisht.

Prof. Petrit MALAJ

**REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE**